

Një studim i shkurtër i Investimeve të huaja në Shqipëri dhe Sërbi

Besim Abdullahi, Mag.

Me qëllim të zbutjes së thashethëmeve lidhur me investimet e huaja në vendet e Ballkanit, do të mundohem të paraqes disa fakte lidhur me këtë faktor të rëndësishëm të zhvillimit Ekonomik e mbi të gjitha tregues të globalizmit.

Investimet e Huaja Direkte (angl. Foreign Direct Investments) janë investimet e aseteve nga (në) vendet e jashtme nga një investitor (person juridik apo natyral). Për dallim nga portfolio investimet, këto Investime dirigjohen krejtësisht në vendin ku realizohen investimet. IHD në vete përfshijnë jo vetëm capital, por edhe investimet në njohuri (dije) dhe teknologji. Rrjedhimisht IHD janë një tregues i shkëmbimit ndërkombëtar e rrjedhimisht një tregues i globalizmit si proces.

Mund të flasim për Investime të Huaja Direkte (sipas FMN – Fondit Monetar Ndërkombëtar) nëse pjesëmarja e huaj në një investim mbrinë 10% e kapitalit të investuar, ndërsa për nga aspekti i Kontrollit në disa raste kjo pjesëmarje duhet të arrijë vlerat mbi 25%.

Nga një raport i EBRD, IHD në shumë më të madhe dhe në rritje deri në vitin 2015 ishin në Mal të Zi, Shqipëri, Sërbi dhe pastaj në Romani dhe Bullgari, duke u ndjekur nga vendet tjera.

COUNTRY	FDI net inflow per capita							
	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Albania	314	310	342	304	297	439	384	346
B&H	282	133	106	130	103	79	131	65
Bulgaria	1.290	592	1.015	400	232	253	247	248
Montenegro	1.472	2.100	1.204	896	993	715	795	1.117
Croatia	1.388	590	132	393	348	216	864	84
Macedonia	288	121	142	232	69	162	131	84
Serbia	304	195	135	607	177	269	267	306
Romania	651	297	166	117	160	172	163	174

Source: EBRD, Transition Report 2009, UNCTAD database (million \$)

Figura 1: IHD në vendet e Ballkanit nga viti 2008 deri në vitin 2015 bazuar në EBRD

Pasiqë me këto vlera nuk mund të jemi të kënaqur, vendosa të kërkoj të dhëna më të sakta dhe aktuale për dy vendet me interes të theksuar për Integrim Ekonomik në BE, Shqipërinë dhe Sërbinë.

IHD në Shqipëri dhe krahasimi i tyre me Sërbinë

Investimet e Huaja Direkte janë dukshëm më të theksuara në Sërbë në krahasim me Shqipërinë. Duke u bazuar në të dhënat nga Banka Popullore e Shqipërisë dhe ajo e Sërbisë, IHD në vitin 2017 në Serbi ishin 3094 Milionë Dollarë Amerikanë (USD), ndërsa në Shqipëri vetëm 1033 Mio USD, që është tri here më pak se ato në Sërbë.




Figura 2: IHD në Shqipëri dhe Sërbë nga viti 2014 deri në vitin 2017 bazuar në Bankat Nacionale të dy vendeve

Normalisht se ne ne si Shqiptarë na brengosë fakti se Sërbë po përparon aq shumë dhe Shqipëria ngelet pas, por e gjithë kjo nuk është aq negative sa duket në shiqim të parë. Ngushëllues është fakti se Investimet e Huaja Direkte efektin e tyre të vërtetë e kanë të ndryshëm në vende të ndryshme. Duke u nisur nga kjo pikë, IHD në Shqipëri kanë efekt zhvillimi në ekonomi në aspekt të ngritjes së Bruto Produktit Vendor - BPV (GDP) prej 3,5% ndërsa në Sërbë vetëm 2,3%. Kjo ndoshta nga arsyeja e Investimit më efikas të IHD në Shqipëri, por ndoshta edhe nga fakti se Ekonomia e Sërbisë është shumë më e madhe se ajo e Shqipërisë për nga aspekti demografik.(burimi: EBRD).

Southeast Europe	GDP average annual % growth			Real GDP growth		Current forecast	
	1990-2000	2000-2009	2009-2014	2014	2015	2016	2017
Albania	3.6	5.7	2.0	2.0	2.6	3.3	3.5
B&H	28.5	5.3	0.8	1.1	3.2	3.0	3.0
Bulgaria	-0.4	5.8	0.9	1.5	3.0	2.5	2.5
Macedonia	-0.8	3.7	2.0	3.8	3.7	3.2	3.5
Kosovo	–	5.3	3.2	1.2	3.0	3.0	3.5
Montenegro	–	4.7	1.4	1.8	3.1	4.0	3.0
Romania	0.0	5.8	1.5	3.0	3.8	4.0	3.5
Serbia	0.7	5.5	0.5	-1.8	0.7	1.8	2.3

Sources: World bank, *World development indicators*, 2016, p. 100-104, available at: <https://issuu.com/world.bank.publications/docs/9781464806834?e=0/35179276>;

EBDR, *Regional Economic Prospects in EBRD Countries of Operations*, May 2016, p. 11, available at: http://ekonomika.by/downloads/EBRD_REP%20May2016_final.pdf

Figura 3: Investimet e Huaja Direkte dhe ndikimi i tyre në rritjen e BPV (GDP) sipas burimeve të Bankës Botërore dhe EBRD (Bankës Evropiane për Rikonstruim dhe Zhvillim)

IHD në Shqipëri dhe Sërbi, dhe Investimet Turke në këto vende

Një hipotezë kasha dëshirë ta vërtetoj apo ta hudhi poshtë si të pavërtetë: Hipoteza se Investimet e Huaja Turke në Sërbi janë më të mëdhaja se në Shqipëri.

Në shikim të parë duke shikuar titujt e gazetave dhe revistave të ndryshme shumë njerëz u influencuan nga përhapja e këtyre të pavërtetave. Prandaj në vazhdim do të bëjmë një analize se cilat ishin vendet që Investuan në Shqipëri dhe cilat në Sërbi.




Figura 4: IHD në Shqipëri sipas Bankës Popullore Shqiptare (BPSH) prej vitit 2014 deri në vitin 2017

Nga të dhënat e BPSH-së, janë paraqitur IHD në Shqipëri sipas vendeve investuese, ku mund të shihet se një nga Investuesit kryesor në Shqipëri radhitet Zvicra si e para me mbi 330 Milionë Euro investime në vitin 2017, pastaj e ndjekur nga investimet Holandeze, Franceze, Italiane dhe Greke. Nëse llogarisim kumulativin e investimeve në katër vitet e fundit e para del Zvicra, e ndjekur nga Holanda dhe Turqia, pastaj vijnë Italia, Greqia dhe Franca.

Pra duke u bazuar në burime të mëparshme të Qeverisë Turke, se Investimet Turke në Ballkan janë shumë të fuqishme sidomos në Shqipëri, ku sipas TRT në Gjuhën Shqipe, përthithësi më i madh i Investimeve Turke në ballkan është Romania me 4 Miliardë USD, Bulgaria me 2.2 Miliardë USD dhe Shqipëria me mbi 2 Miliardë USD Investime në Kumulativ në dhjetë vitet e fundit. (burimi: <http://www.trt.net.tr/shqip/ekonomia/2017/10/03/koment-investimet-direkte-te-turqise-ne-ballkanin-perendimor-818930>).




Figura 5: Top 5 vendet Investuese në Shqipëri nga v. 2017 deri në vitin 2017 sipas BPSH-së

Nga të dhënat e BPSH-së gjithashtu mund të shohim pesë investuesit më të mëdhenjë në Shqipëri, të cilat janë Turqia, Zvicra, Holanda, Italia dhe Franca. Nga Italia ngelet shumë për tu dëshiruar, duke u nisur nga fakti se Italia është importuesi bindshëm më i madh i mallrave dhe shërbimeve në Shqipëri, ku vetëm në vitin 2017 ka importuar mallra dhe shërbime në vlerë prej 179 Mio Euro.

Por kjo nuk mjafton për të rrëzuar hipotezën tone që vendosëm në fillim, pasi që duhet të përdëftojmë se investimet Turke në Serbi janë shumë më të vogla se në Sërbi.

Table 2: Yearly FDI Outflow from Turkey to the Western Balkans (In Millions of Dollars)

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Albania	3	5	5	10	14	18	31
Bosnia And Herzegovina	61	22	7	3	0	35	26
Croatia	3	47	103	0	23	37	15
Macedonia	8	71	12	5	2	11	10
Montenegro	4	0	0	11	0	11	15
Serbia	3	0	7	4	0	16	11
Total	82	145	134	33	39	128	108

Source: Central Bank of the Republic of Turkey

Figura 6: IHD të Turqisë në vendet e Ballkanit (outflow) sipas Bankës Qendrore Turke

Nga tabela e të dhënave nga Banka Qendrore Turke (BQT – TCB) mund të shihet se Investimet e Huaja Turke në Shqipëri jo vetëm që janë më të lartat në krahasim me vendet tjera, por shënojnë një rritje të vazhdueshme, duke aritur maksimumin në vitin 2016 me mbi 31 Milionë USD, që janë trefishi i investimeve Turke në Sërbi, ku në vitin 2016 ka patur vetëm 11 Milionë USD investime Turke, e as që krahasohet në kumulativ me shumën e Investimeve Turke në Shqipëri, mos të flasim për atë se Shqipëria për kokë banori ka dyfishin e shumës që ka Sërbia për sa i përket investimit Turk në këto vende respektivisht.

Që mos të jemi të njëanshëm në analizat tona, në vazhdim po ju sjellim edhe të dhënat nga Banka Qendrore e Sërbisë, respektivisht Agjensionit Sërb për Zhvillim (Serbian Agency for Development), ku paraqiten investuesit më të mëdhenjë në Sërbi e ku nuk figuron aspak Turqia. Kjo vërtetohet edhe nga të dhënat e Agjensionit Sërb për promovimin e Eksportit, ku paraqiten IHD më të mëdhaja në Sërbi sipas kompanive dhe prejardhjes së tyre.




Figura 7: Investuesit e huaj në Sërbi deri në vitin 2016 sipas DAS (Agjensionit Sërb për Zhvillim)

Përderisa Itali është e interesuar vetëm të importon produkte në Shqipëri, po preferon të investon dhe prodhon të njejtat produkte në Sërbi, së paku sipërfaqësisht në bazë të dhënave që paraqiten nga ky burim (figura 7) ku Italia kryeson bindshëm për nga numri i projekteve investive (HDI) në Sërbi me 18%, e ndjekur nga Gjermania dhe Austria. Përsëri përsëri Turqisë edhe Zvicra ngelet besnike e Shqipërisë për sa i përket IHD në Shqipëri, së paku deri në fund të vitit 2017. Më tutje mvaret nga politikat tona dhe të përfaqësuesve tanë.

Largest Foreign Investments in Serbia

Company	Country of origin	Industry branch	Type of investment	Amount million euros
Telenor	Norway	Telecommunications	Privatization	1.602
Gazprom Neft	Russia	Energy	Privatization	947
Fiat Automobiles	Italy	Automotive industry	Joint venture	940
Delhaize	Belgium	Retail	Acquisition	933
Philip Morris	US	Tobacco industry	Privatization	733
Stada Hemopharm	Germany	Pharmaceuticals	Privatization	650
VIP Mobile	Austria	Telecommunications	Greenfield	633
Agrokor	Croatia	Retail	Greenfield	614
Intesa	Italy	Banking	Acquisition	508
Salford Investment Fund	UK	Food industry	Acquisition	500

Source: SIEPA (Serbia Investment and Export Promoting Agency)

Figura 8: Investimet më të mëdha në Sërbi sipas Agjensionit Serb për promovimin e eksportit

Konkluzion

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, u vërtetua se IHD në Shqipëri janë në rritje të vazhdueshme, si tregues i mirë i zhvillimit Ekonomik dhe ngritjes së mirëqenjes për qytetarët e sajë, gjithashtu kjo tregon rrugen që ndjek Shqipëria drejt Globalizimit.

U vërtetua se Investimet e huaja direkte të Turqisë në Shqipëri janë nga më të mëdhat në rajon nga vendet jashta BE-së, por njëkohësisht u vërtetua se Investimet Turke në Sërbi janë të papërfillshme e as që krahasohen me ato të realizuara në Shqipëri, ku që nga viti 2007 në kumulativ arrijnë vlerën prej 2 Miljardë USD, kjo paraqet shumën më të lartë në rajon edhe atë ndaj një vendi të BE-së si Greqia, ku investimet Turke janë më të ulëta, me përjashtim të Romanisë dhe Bullgarisë me 4 Miljardë USD dhe 2,2 Miljardë USD respektivisht.